



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 80, Datë 06.04.2018

MBI

MIRATIMIN E RREGULLAVE OPERACIONALE PËR FURNIZUESIN E MUNDËSISË SË FUNDIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenit 90, pika 10 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 06.04.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me miratimin e “Rregullave Operacionale për furnizuesin e mundësisë së fundit, të gazit natyror”,

Konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 90 pika 10 të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, ERE miraton “Rregullat operacionale për furnizuesin e mundësisë së fundit të gazit natyror”.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 41, datë 23.02.2018, filloi procedurën për miratimin e Rregullave Operacionale për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit të sektorit të gazit natyror.
- Me shkresën nr. 55/8 Prot., datë 26.02.2018, është publikuar në median e shkruar njoftimi për fillimin e procedurës për miratimin e draft- “Rregullave Operacionale për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit të sektorit të gazit natyror”.
- Me shkresën nr. 220 Prot., datë 28.02.2018, u kërkuan komente dhe opinione nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Autoriteti i Konkurrencës, Albgaz sh.a, Anio Oil & Gas sh.p.k, Phoenix Petroleum sh.a dhe C.G.C sh.p.k.
- ERE në datën 01.03.2018 ka dërguar gjithashtu në formë elektronike këtë draft pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për të marrë komentet e tij.
- Në përfundim të afatit të marrjes së komenteve dhe opinioneve nga palët rezultoi se Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 166/1 Prot., datë 21.03.2018, ka deklaruar se

draft – “Rregullat operacionale, për furnizuesin e mundësisë së fundit, të sektorit të gazit natyror”, nuk bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë “Rregullat Operacionale për furnizuesin e mundësisë së fundit të gazit natyror”. (Bashkëlidhur)
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.